



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 163

Tiranë – E martë, 19 tetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13270, datë 15.10.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 15037
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 19, datë 7.10.2021	Për krijimin e Regjistrit të Konsoliduar Kombëtar të Fermës..... 15037
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 15.10.2021	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 16, datë 3.4.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”..... 15038
Vendim i Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve nr. 1259/10, datë 15.10.2021	Për rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve..... 15039
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 198, datë 1.10.2021	Mbi miratimin e kërkesës së subjektit GEK Terna Group, për aplikim në TAP AG, për fazën jo të detyrueshme në treg – testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e termocentralit me cikël të kombinuar, me fuqi 160–180 mw, në Roskovec, Fier..... 15039
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 199, datë 1.10.2021	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës nr. 11, seria PV03K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003..... 15040
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 200, datë 1.10.2021	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 3.3.2014..... 15042
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 201, datë 1.10.2021	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar..... 15043

Vendim i Entit Rregullator të
Energjisë nr. 202, datë 1.10.2021

Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë
10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në
aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, të ndryshuar..... 15044

Vendim *(i shkurtuar)* për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar
shtetases Rugova Qelia..... 15045

**DEKRET****Nr. 13270, datë 15.10.2021****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14 e 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Ilgaz Sulejman Rasimi
2. Rrolf Ali Rexhaj
3. Eva Agim Walter (Rushitaj)
4. Mimoza Njazi Ndroqi
5. Aida Izedin Baldari
6. Felix Christian Fabio Baldari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM**Nr. 19, datë 7.10.2021****PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT TË
KONSOLIDUAR KOMBËTAR
TË FERMËS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; dhe të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim përcakton rregullat e krijimit dhe të integritetit të të dhënave për fermën, Regjistri

Kombëtar i Fermës, si bazë e integruar dhe e unifikuar e të dhënave të mbajtura nga Agjencitë e Ekstensionit Bujqësor në regjistrat rajonalë të fermës dhe të të dhënave të tjera të administruara nga institucionet shtetërore dhe aplikuesit; popullimit të të dhënave; lëshimin e kartës së fermerit; mënyrën e përdorimit dhe të aksesit, si dhe veprimtari të tjera administrative.

2. Të gjithë termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

3. Regjistri Kombëtar i Fermës ka si qëllim:

a) pasqyrimin dhe gjenerimin e të dhënave për fermat, për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) unifikimin e të dhënave dhe kompjuterizimin e tyre, duke integruar të dhëna nga sistemi RUDA, skema e naftës për bujqësinë, të dhënat nga administrata tatimore;

c) pajisja e fermerëve me kartë fermeri;

d) përditësimi dhe përmirësimi periodik i bazës së integruar të të dhënave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) aksesit i fermerëve, duke filluar nga regjistrimi, pajisja me kartë fermeri dhe përditësimi i të dhënave;

f) përdorimi i bazës së të dhënave për qëllime statistikore dhe dhënies së mbështetjes shtetërore për fermerët;

g) kalimi i të dhënave për Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural.

4. Regjistri Kombëtar i Fermës do të përmbajë të dhëna detyruese që në krijimin e tij, që transferon nga regjistrat rajonalë, si vijon:

a) për pronarin e fermës: i. emër, atësi, mbiemër; datëlindje; adresa e vendbanimit, numri personal dhe numër telefoni ose adresë tjetër për komunikim; personi fizik: emër, atësi, mbiemër; datëlindje; adresa e vendbanimit, numri personal, NUIS, numër telefoni ose adresë tjetër për komunikim; emri i subjektit, forma e organizimit, selia dhe NUIS, dhe për përfaqësuesin ligjor: emër, atësi, mbiemër; datëlindje; numri personal, numër telefoni ose adresë tjetër për komunikim;

b) kodin e fermës, i cili siguron identifikimin unik të fermës dhe mundëson identifikim të vendndodhjes administrative;

c) vendndodhja e fermës;

d) statusi i fermës në kohë reale.



5. Regjistri Kombëtar i Fermës do të përditësohet me të dhëna shtesë që transferohen nga regjistrat rajonalë, sipas vetëdeklarimit të aplikuesit ose të administruara në rrugë zyrtare, si vijon:

a) sipërfaqja totale e tokës në fermë, sipërfaqet e secilës parcelë, si dhe lidhja juridike (pronësi, qira, huapërdorje ose një formë tjetër), vendndodhja me hartë kadastrale ose adresë ngastre;

b) vendndodhja e fermës;

c) aktivitetet e fermës me të dhëna përkatëse;

d) mekanika bujqësore me të dhëna mbi çdo mjet;

e) përfitimet nga çdo skemë kombëtare mbështetëse ose financime nëpërmjet institucioneve shtetërore;

f) masat administrative të ekzekutueshme;

g) dokumente mbështetës/provues.

6. Regjistrimi i fermës për herë të parë, pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bëhet me kërkesë dhe karta e fermerit lëshohet me plotësimin e të dhënave, sipas pikës 4 të udhëzimit. Përditësimi dhe popullimi i të dhënave bëhet me vetëdeklarim ose si veprimtari administrative.

7. Detyrat e Agjencive të Ekstensionit Bujqësor:

a) sigurimin e plotësimit të regjistrat rajonal me të dhëna të verifikuara dhe në kohë reale;

b) pranimi i aplikimeve nga fermerët dhe popullimi i të dhënave, sipas vetëdeklarimit të fermerit ose sipas informacioneve dhe dokumentacionit të administruar nga sistemet e tjera, si sistemi RUDA, Skemat Kombëtare të Mbështetjes, Skema e Mbështetjes së Naftës në Bujqësi, programi IPARD etj.;

c) lëshimi i kartës së fermerit;

d) popullimi dhe përditësimi i të dhënave;

e) kalimi i të dhënave në mënyrë periodike në Regjistrin Kombëtar të Fermës.

8. Detyrat e grupit të punës në ministri:

a) sigurimi i plotësimit dhe i përditësimit të Regjistrat Kombëtar të Fermës, sipas përcaktimeve të udhëzimit dhe të dhënave të regjistrat rajonal;

b) garantimi i përdorimit të të dhënave dhe kalimi i të dhënave për Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural dhe institucionet e tjera të varësisë;

c) komunikimi me administratën tatimore për shkëmbim të dhënash.

9. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave dhe përditësimi i tyre do të miratohet me urdhër

ministri dhe do të zbatohet në të gjithë territorin në mënyrë të unifikuar.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, drejtorja e përgjithshme që ka në varësi AREB-et dhe grupet e punës.

11. Udhëzimi nr. 14, datë 20.10.2020, “Për krijimin dhe mbajtjen e Regjistrat Kombëtar të Fermës”, shfuqizohet.

12. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

UDHËZIM
Nr. 22, datë 15.10.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 16, DATË 3.4.2020, “PËR FATURËN
DHE SISTEMIN E MONITORIMIT
TË QARKULLIMIT”

Në mbështetje të nenit 102, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 47, të ligjit nr. 87/2019, datë 18.12.2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON

Neni 1

Pika 2, e nenit 8 “Momenti i lëshimit të faturës”, të udhëzimit nr. 16, datë 3.4.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, riformulohet si më poshtë vijon:

“2. Për furnizime në rastin e telekomunikacionit, transmetimit dhe shërbimeve elektronike për persona të patatueshëm, që kanë adresën e tyre të përhershme ose banojnë në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 29, të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, furnizuesi i huaj, nëpërmjet përfaqësuesit të tij tatimor në Republikën e Shqipërisë, lëshon fatura dhe zbaton procedurën e fiskalizimit, në përputhje me ligjin, në momentin e furnizimit, ose mund të lëshojë një faturë periodike



jo më vonë se data 10 e muajit që pason muajin në të cilin janë dhënë shërbimet.”

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

VENDIM

Nr. 1259/10, datë 15.10.2021

PËR REZULTATIN E ZGJEDHJEVE DHE SHPALLJEN E FITUESVE

Në mbështetje të nenit 115, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Votimit, me përbërje:

Alma Muça kryetar;

Thoma Jano anëtar;

Kudusi Shahu anëtar,

pasi u administrua gjithë dokumentacioni i votimit, numëroi votat, përpiloi procesverbalin përkatës,

VËREN:

Në përfundim të procesit të votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e tre anëtarëve prokurorë për Këshillit e Lartë të Prokurorisë, kandidatët sipas numrit më të madh të votave të vlefshme, renditen në mënyrën si vijon:

Për anëtar prokuror, nga radhët e prokurorive të shkallëve të para:

Zeqir Hoha 150 vota;

Deniona Katro 48 vota;

Elona Alvora 6 vota.

Për anëtar prokuror, nga radhët e prokurorive të apeleve:

Ludovik Dodaj 192 vota.

Për anëtar prokuror, nga radhët e Prokurorisë së Përgjithshme:

Sokol Stojani 195 vota.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenin 115, paragrafët 5 e 7, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të

drejtësisë” dhe nenit 15 të rregullores së Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, komisioni

VENDOSI:

1. Të shpallë fitues si përfaqësues të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë:

z. Zeqir Hoda

2. Të shpallë fitues si përfaqësues të prokurorive të apelit:

z. Ludovik Dodaj

3. Të shpallë fitues si përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme:

z. Sokol Stojani

4. Ky vendim të shpallet zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme.

5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I VOTIMIT

Kryetar: Alma Muça

Anëtarë: Thoma Jano, Kudusi Shahu

VENDIM

Nr. 198, datë 1.10.2021

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SUBJEKTIT GEK TERNA GROUP, PËR APLIKIM NË TAP AG, PËR FAZËN JO TË DETYRUESHME NË TREG - TESTI I TAP AG, PËR KAPACITETIN DHE LIDHJEN E TERMOCENTRALIT ME CIKËL TË KOMBINUAR, ME FUQI 160– 180 mw, NË ROSKOVEC, FIER

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13, 15, pika 1, germa “a”; 16, pika 24; 25; 17, pika 4; 19, pika 5 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të vendimit nr. 122, datë 11.5.2021, të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e propozimit të projekteve TAP, SRG dhe DESFA, për procesin e rritjes së kapacitetit për vitin 2019”; të seksionit 4.7, pika 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, korrik 2013, si dhe opinionin 1/2013, të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013, “Mbi përjashtimin e ndërlidhësit TAP AG nga kërkesa të caktuara, sipas direktivës



2009/73/EC, nga Autoriteti Rregullator i Energjisë në Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 1.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 123/5 prot., datë 29.9.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi “Kërkesën e subjektit GEK Terna Group, për aplikim në TAP AG, për fazën jo të detyrueshme në treg – testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e termocentralit me cikël të kombinuar, me fuqi 160–180 mw, në Roskovec, Fier”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 910, datë 1 shtator 2021, GEK Terna Group paraqiti tek Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (ERE) “Kërkesën për aplikim nga GEK Terna Group, për fazën jo të detyrueshme në treg - testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e termocentralit me cikël të kombinuar, me fuqi 160–180 mw, në Roskovec, Fier”; në përputhje me nenin 4.7, pika 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë dhe me direktivën 2003/55/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 26 janar 2003, lidhur me rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të gazit natyror;

- TAP AG, sipas neneve 4.1, pika 7 dhe 4.7, pika 2, 6 dhe 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, është e detyruar të plotësojë kërkesat për kapacitetin detyrues/lidhës të cilat rezultojnë nga çdo testim tregu.

- Referuar njoftimit të fazës jodetyruese për testin e tregut TAP AG 2021, kërkesat nga palët e interesuara, për lidhjet/kapacitetet jodetyruese, duhet të paraqiten në TAP AG deri më datë 11 tetor 2021.

- Faza jodetyruese e testimit të tregut, për vitin 2021, nga Gazsjellësi Trans Adriatik, ka filluar në 12 korrik 2021. Testi i tregut duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet e miratuara bashkërisht me autoritetet rregullatore italiane (ARERA), greke (RAE) dhe shqiptare (ERE).

- GEK Terna Group shprehet se është në fazën paraprake, jo të detyrueshme, të përcjelljes së njoftimit/kërkesës, për lidhjen dhe kapacitetin e gazit natyror pranë shoqërisë TAP AG dhe është

në përputhje me parimet e përcaktuara në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, me udhëzimet e testit të tregut, si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit.

- Duke qenë se aplikimi nga GEK Terna Group është në përputhje me parimet e përmendura në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, udhëzimet e testit të tregut, “Kodin e rjetit për mekanizmat e alokimit të kapacitetit”, si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit, ERE nuk ka kundërshtime për këtë kërkesë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Kërkesën e subjektit GEK Terna Group, për aplikim në TAP AG, për fazën jo të detyrueshme në treg - testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e termocentralit me cikël të kombinuar, me fuqi 160–180 mw, në Roskovec, Fier”, të paraqitur nga GEK Terna Group.

2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
KOMISIONERI
Adriatik Bego

VENDIM
Nr. 199, datë 1.10.2021

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PËR HEQJEN E
LICENCËS NR. 11, SERIA PV03K, PËR
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË
SHOQËRISË “SPAHIU GJANÇ” SHPK,
ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 20, DATË 19.12.2003**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 95 dhe të nenit 113, të Kodit të Procedurave



Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015; të nenit 7, 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ere-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 123/1 prot., datë 24.9.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës, “Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 185, datë 10.9.2021, Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 11, seria PV03K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Spahiu Gjanç’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003”

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 185, datë 10.9.2021, vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 11, seria PV03K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003.

- Ky vendim u mor për arsye se shoqëria “Spahiu Gjanç” sh.p.k. nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2020, për licencën, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument, në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 952 prot., datë 15.9.2021, shoqëria është njoftuar për vendimarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE, në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezultoi se shoqëria i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitoare ndaj ERE-s.

- Në nenin 8, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: “Pas marrjes së përgjigjes më

shkrim nga i licencuari, sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë do të shqyrtojnë këtë përgjigje, brenda 30 ditëve, dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t’i propozojnë Bordit: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat: “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje.

- Në nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative, pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast “qëllimi” i procedurës lidhet ngushtësisht me marrjen e masave administrative kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimarrjen. Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të dispozitës së mësipërme, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% të vlerës së debisë nga shoqëria “Spahiu Gjanç” sh.p.k.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura, fakton ndryshimin e statusit të subjektit, të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që çoi marrjen e masës për fillimin e procedurës, për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: “Me marrjen e informacionit të detajuar, me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative, të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 185, datë 10.9.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e



licencës nr. 11, seria PV03K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Spahiu Gjanç’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003”.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 185, datë 10.9.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 11, seria PV03K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Spahiu Gjanç’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
KOMISIONERI
Adriatik Bego

VENDIM
Nr. 200, datë 1.10.2021

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PËR HEQJEN E
LICENCËS NR. 224, SERIA T14P, PËR
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË
SHOQËRISË “SPAHIU GJANÇ” SHPK,
ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 14, DATË 3.3.2014**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 95 dhe nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015; neneve 7, 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i

Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 123/1 prot., datë 24.9.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 185, datë 10.9.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 3.3.2014,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 186, datë 10.9.2021, vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 3.3.2014.

- Ky vendim u mor për arsye se shoqëria “Spahiu Gjanç” sh.p.k. nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2020 për licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument, në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 952 prot., datë 15.9.2021, shoqëria është njoftuar për vendimmarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezultoi se shoqëria i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitor ndaj ERE-s.

- Në nenin 8, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet, se: “Pas marrjes së përgjigjes më shkrim nga i licencuari, sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t’i propozojnë Bordit: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës, në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje”.



- Në nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative, pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast “qëllimi” i procedurës, lidhet ngushtësisht me marrjen e masave administrative kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimmarrjen. Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të dispozitës së mësipërme, është bërë i pamundur, për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% vlerës së debisë nga shoqëria “Spahiu Gjanç” sh.p.k.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura, fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që çoi marrjen e masës për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet, se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.9.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Spahiu Gjanç’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 3.3.2014”.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.9.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 3.3.2014”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
KOMISIONERI
Adriatik Bego

VENDIM Nr. 201, datë 1.10.2021

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ALBGAS’ SHA NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, pika 12; neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 44/2015; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 123/4 prot., datë 29.9.2021, “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 153, datë 30.6.2021, ndër të tjera, vendosi:



1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, si më poshtë:

- Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që:

a) brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore;

b) brenda datës 30.9.2021, të depozitojë në ERE certifikatën e sigurimit.

- Dokumentacioni, i cili duhet të plotësohet nga shoqëria “Albgaz” sh.a. deri në datën 20.9.2021, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187/2017, të ndryshuar, është si më poshtë:

- Depozitimi në ERE i një certifikate sigurimi (neni 9, pika 1, germa “e”, “iv”), e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar që lidhet me certifikatën e sigurimit deri në datën 20.1.2022, duke argumentuar se aktualisht ka nisur procedurën e prokurimit për përzgjedhjen e subjektit, i cili do të pajisë këtë të fundit me certifikatë sigurimi.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citon, se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e bordit të ERE-s nr. 153, datë 30.6.2021.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

“- Të licencojë shoqërinë ‘Albgaz’ sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një

afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
KOMISIONERI
Adriatik Bego

VENDIM
Nr. 202, datë 1.10.2021

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË
10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘ALBGAZ’ SHA NË
AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË
GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 12; të neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 44/2015, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 123/4 prot., datë 29.9.2021, “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, ‘Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të ndryshuar”;

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 153, datë 30.6.2021, vendosi:



1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, si më poshtë:

“- Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që:

a) brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore;

b) brenda datës 30.9.2021, të depozitojë në ERE certifikatën e sigurimit.”

- Dokumentacioni i cili duhet të plotësohet nga shoqëria “Albgaz” sh.a. deri në datën 20.9.2021, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188/2017, të ndryshuar, është si më poshtë:

- depozitimi në ERE i një certificate sigurimi (neni 9, pika 1, germa “e”, “iv”), sipas “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar, që lidhet me certifikatën e sigurimit, deri në datën 20.1.2022, duke argumentuar se aktualisht ka nisur procedurën e prokurimit për përzgjedhjen e subjektit, i cili do të pajisë këtë të fundit me certifikatë sigurimi.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citon se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 153, datë 30.6.2021.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

“- Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
KOMISIONERI
Adriatik Bego

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. 21013-00088-54, datë 23.6.2021, vendosi heqjen e zotësisë juridike për të vepruar për shtetasen Rugova Qelia, si dhe caktimin e shtetases Nadire Qelia, në cilësinë e kujdestares ligjore të saj.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë